



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:011214

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05527252

C.nr.371/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtorin profesional Milot Mehmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F. Bl. nga Gj., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Malsore Halili, avokate nga Vitia, kundër të paditurës K. e Gj. – D. Ko. e A., me objekt kontesti pagesa e inflacionit, me vlerë të kontestit 708.95 euro, jashtë seancës, me datë 26.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses F. Bl. nga Gj. dhe DETYROHET e paditura K. e Gj.– D. K. e A. që në emër të inflacionit vjetor për periudhën kohore Janar 2021– Nëntor 2022 (duke marrë për bazë pagën bazë të paditësit prej 421.00 euro), t’ia paguaj shumën prej 708.95 euro, me kamatë ligjore prej 8 % duke llogaritur nga data 22.12.2023 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura që t’ia paguaj shpenzimet e procedurës paditësit në shumën e përgjithshme prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuares së saj, më 22.12.2023 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për pagesën e inflacionit, në vlerë të kontestit prej 708.95 euro.

Në padi ka theksuar se e njejta është e punësuar në Shkollën Fillore të Mesme e Ulët (në vijim: SHFMU) “Z. Sh.” në Gj., në pozitën mësimdhënëses, ku edhe vazhdon të jetë në këtë pozitë me orarë të plotë të punës. Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të vitit 2017 dhe 2021 ka theksuar se paditësit i takon e drejta që t’i llogaritet lartësia e inflacionit vjetor dhe i njëjti të përfshihet në pagën e tij për periudhën kohore Janar 2021 –Nëntor 2022, për përqindjen prej 3.4 % për vitin 2021 dhe 11.6 % për vitin 2022 bazuar në të dhënat nga Agjencioni Statistikor i Kosovës. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumave të aprovuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 21.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të

cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi për inflacion, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar te e paditura (fakt i provuar edhe nga vërtetimi me nr.prot.11/119/23 i dt.04.12.2023 lëshuar nga SHFMU “Zija Shemsiu” në Gjilan) dhe paga bazë e saj është 421.00 euro – (lista e pagës e lëshuar në emër të paditësit nga BRK).

Nuk është kontestuese se përqindja e shkallës së inflacionit sipas entit të statistikave për vitin 2021 është 3.4 %, ndërsa për vitin 2022 është 11.6 % (fakt i provuar nga të dhënat e lëshuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Nga të njëjtat gjykata provoi se paga bazë e paditësit është 421.00 euro dhe përqindja e shkallës së inflacionit sipas entit të statistikave për vitin 2021 është 3.4 %, ndërsa për vitin 2022 është 11.6 %.

Gjykata duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare, e as gjendjen faktike, por vetëm bazën e kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90, paragrafi 5 se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”; lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të

Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, nga neni 3, paragrafi 2 që përcakton se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”; neni 35, paragrafi 10 se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017 – 21.01.2021 dhe për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Nga këto, gjykata ka gjetur se paditësja ka provuar se gjatë periudhës sa kanë qenë në fuqi të dy kontratat kolektive ka kërkuar kompensimin sipas shkallës së inflacionit, ndërsa ky kompensim arrin lartësinë e aprovuar si në këtë aktgjykim, sipas shkallës së llogaritur nga enti i statistikave (neni 35.10 i KKAK).

Gjykata vlerëson se periudha kohore e kërkuar për këtë kompensim nuk është e përfshirë në parashkrim siç e pretendon e paditura, pasi bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, padia është parashtruar më datë 22.12.2023, kurse kërkesa është llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e parashtrimit të kërkesës, përkatësisht nga muaji Janar i vitit 2021.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se inflacioni nuk mund të kërkohej vetëm në një sektor të punës, gjykata vlerëson se me kontratë kolektive është përcaktuar se inflacioni ka ndikim në pagën e mësimdhënësve, prandaj edhe këtë pretendim e gjeti të pabazuar.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.371/24, datë 26.03.2024

Gjyqtarja
Florije Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.